



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2024

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

BILANCI I GJENDJES

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

5 - 16

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të fondacionit më 31 Dhjetor 2024, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionalistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizaës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.

I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.

Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



“Quatra Audit” INT LLC
Fahri Breznica
Prishtinë, Kosovë

18 Mars 2025

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD**Bilanci i gjendjes****Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024**

	Shënimi	Më 31 Dhjetor 2024 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2023 (në EUR)
ASETET			
Asetet qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	69,200	130,488
Llogaritë e arkëtueshme	4	51,452	17,468
Totali i aseteve qarkulluese		120,652	147,956
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Totali i aseteve jo-qarkulluese		-	-
TOTALI I ASETEVE		120,652	147,956
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Obligimet ndaj donatorit		-	-
Llogaritë e pagueshme	5	63	541
Të hyrat e shtyera	6	120,588	147,415
Totali i detyrimeve rrjedhëse		120,652	147,956
Ekuiteti			
Fitimi i mbajtur		-	-
Profit/Humbja neto e vitit		-	-
Totali i ekutetit		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		120,652	147,956

Pasqyrat financiare janë nënshkruar më 18 Mars 2025 nga:


Ehat Miftaraj
Drejtor Ekzekutiv
Xheladin Bytyqi
Zyrtari për financa

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD**Pasqyra e të ardhurave****Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024**

	Shënimi	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2024 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Të hyrat			
Të hyrat nga grantet	7	897,797	784,146
Kthimi i fondeve		-	-
Totali i të hyrave		897,797	784,146
Shpenzimet			
Pagat - Menaxhmenti dhe Administrata	8	85,528	86,491
Pagat - Stafi për Aktivitetet Programore	8	414,941	401,496
Shpenzimet e produksionit	9	177,720	118,651
Shpenzimet tjera operative	10	219,608	177,508
Totali i shpenzimeve		897,797	784,146
Teprica e të hyrave ndaj shpenzimeve		-	-

Pasqyrat financiare janë nënshkruar më 18 mars 2025 nga:


Ehat Miftaraj
Drejtor Ekzekutiv
Xheladin Bytyqi
Zyrtari për financa

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

	Mbetja (në EUR)	Totali i mbetjes (në EUR)
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	<u>-</u>	<u>-</u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2022	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	<u>-</u>	<u>-</u>
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	<u>-</u>	<u>-</u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2023	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	<u>-</u>	<u>-</u>
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	<u>-</u>	<u>-</u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2024	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD**Pasqyra e rrjedhës së parasë****Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024**

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2024 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/surplusi gjatë periudhës	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlersimin	-	-
Obligimet ndaj donatorit	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshme	(33,984)	(11,724)
Ndryshimet në të pagueshme	(478)	(1,828)
Ndryshimet në detyrime tjera	(26,827)	34,458
Paratë e gjeneruara nga operimet	(61,289)	20,906
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Paraja neto e përdorur në investime	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	(61,289)	20,906
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	130,488	109,583
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	69,200	130,488

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD

Shënimet e pasqyrave financiare

Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

1. HYRJE

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është organizatë e pavarur joqeveritare dhe jofitimprurëse, fabrikë e mendimeve e specializuar në fushën e drejtësisë, që merret me avancimin e së drejtës. I themeluar më 4 shkurt të vitit 2009, instituti funksionon si shoqatë profesionale, e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me numër 5112193-7 në krye të së cilës qëndron Kuvendi i Anëtarëve. Veprimtaria e IKD-së udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv, i cili këshillohet nga Bordi Këshillëdhënës i organizatës.

Misioni i IKD-së është forcimi i sundimit të ligjit dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi për qytetarët.

Vizioni i IKD-së është konsolidimi i shoqërisë me vlera demokratike, e cila respekton dhe promovon parimet e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Qëllimi i IKD-së është avancimi i vazhdueshëm i së drejtës në Kosovë. Këtë qëllim synojmë arrijmë përmes veprimtarisë sonë hulumtuese, publikuese e avokuese, të cilën e organizojmë në shtatë programe që na mundësojnë një qasje gjithëpërfshirëse të intervenimit, prej bërjes së ligjeve e deri të zbatimi i tyre nga institucionet përgjegjëse.

Veprimtarinë e vet, instituti e zhvillon përmes strukturës programatike. 1) Bërja e ligjit; 2) Sundimi i Ligjit; 3) Antikorrupsioni; 4) Drejtësia në zgjedhje; 5) Edukimi; 6) Media 7) Qasja në drejtësi dhe 8) Qeverisja e mirë.

Qasja dhe parimet

Duke u siguruar se ligji i vendit bëhet përmes një procesi transparent e gjithëpërfshirës dhe zbatohet përmes një sistemi efikas të përgjegjësisë dhe llogaridhënies të institucioneve të drejtësisë, IKD ndërton bazën e veprimeve të saj drejt qëllimit institucional. Përmes programeve specifike për drejtësi në zgjedhje dhe kundër korrupsionit, këto veprimtari sintetizohen në një qasje gjithëpërfshirëse drejt avancimit të drejtësisë në Kosovë, qasje të cilën e kompletojmë përmes aktiviteteve tona edukative e vetëdijësuese.

IKD vazhdimisht boton raporte që dalin nga puna jonë hulumtuese e monitoruese, natyra e të cilave shtrihet përgjatë gjithë spektrit të së drejtës, prej emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, te reformat e sistemit të drejtësisë, e deri të llogaridhënia brenda këtij sistemi.

Parimet që e udhëheqin veprimtarinë tonë janë **saktësia, transparenca dhe llogaridhënia.**

Aktivitetet e IKD-së

Instituti i Kosovës për Drejtësi, në veprimtarinë e tij, ndërmerret këto aktivitete:

Hulumtim ligjor, ku përfshihet, mes tjerash, hulumtimi i politikave publike që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, analiza cilësore dhe krahasuese të ligjeve dhe politikave publike, analiza krahasuese mes Kosovës, Rajonit dhe Evropës.

Hulumtim gazetaresk, ku përfshihet identifikimi i çalimeve, praktikave të këqija, mosrespektimit të rregullave dhe procedurave si dhe hulumtime tjera të rasteve të veçanta, që janë me interes për publikun.

Analizë dhe ekspertizë ligjore, përfshirë përkrahjen ligjore dhe teknike për institucionet e sundimit të ligjit.

Avokim, përfshirë avokimin e drejtpërdrejt tek institucionet, avokimin përmes medias, mobilizimin e sektorit të juristëve dhe të shoqërisë civile për çështje të interesit të veçantë.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

Raportimin, përfshirë raportimin televiziv dhe atë të shkruar online, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit të sundimit të ligjit, informimin e qytetarëve për këtë sistem, funksionimin dhe reformimin e tij, me fokus të veçantë përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Monitorimin sistematik të punës së institucioneve të sundimit të ligjit, përfshirë policinë, prokurorinë, gjykatat si dhe Odën e Avokatëve, si dhe nxjerrjen e raporteve periodike dhe atyre të veçanta që dalin nga procesi i monitorimit.

Përkrahja e vazhdueshme teknike dhe substanciale e institucioneve të Republikës, përmes pjesëmarrjes aktive në grupet punuese për nisjen dhe amendamentimin e legjislacionit, si dhe grupeve tjera profesionale, duke u nisur nga faza e koncept dokumenteve e deri te revidimet e ligjeve në Kuvend.

Përfaqësimin e komunitetit të juristëve dhe të shoqërisë civile, në proceset legjislative dhe luajtjen e rolit të urës ndërlidhëse mes sistemit të sundimit të ligjit dhe shoqërisë.

Promovimi i vazhdueshëm i parimeve të ndarjes së pushteteve, promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut me fokus të veçantë në të drejtat përgjatë procedimeve në sistemin e drejtësisë.

Promovimi i rolit të pushtetit gjyqësor me fokus të veçantë në informimin për rolin e prokurorëve dhe gjyqtarëve si dhe institucioneve të pushtetit gjyqësor si KGJK dhe KPK.

Nxitjen e funksionimit të institucioneve të sundimit të ligjit, përfshirë këtu nxitjen për transparencë, sistem funksional të llogaridhënies dhe mbajtjes në përgjegjësi, si dhe bashkëpunimin mes institucioneve të sundimit të ligjit.

Vlerësimin e zbatimit të politikave dhe ligjeve, përfshirë ligjet, strategjitë, planet e veprimit dhe dokumenteve tjera politike sa i përket sundimit të ligjit.

Organizimi i debateve, qoftë debateve të brendshme mes institucioneve dhe akterëve, qoftë tryezave publike apo debateve televizive, për çështjet të rëndësishme në fushën e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor.

Produktet e IKD-së

Instituti i Kosovës për Drejtësi, pos produkteve ad-hoc dhe të rastit, prodhon këto produkte të vazhdueshme:

- Raportet periodike të monitorimit të gjykatave
- Raportet periodike të monitorimit të prokurorive
- Raportet periodike të monitorimit të policisë
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve të korrupsionit
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve të veprave penale karakteristike
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve civile
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve administrative
- Hulumtime dhe analiza të politikave publike sa i përket sundimit të ligjit, specifikisht sistemit të drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit
- Reagime të shpejta publike për çështje të caktuara

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

- Analiza të ligjeve dhe pajtueshmërisë së tyre me standardet e BE-së dhe OKB-së
- Konstruktimi i platformës së burimeve të informacionit, statistikave dhe të dhënave tjera, që dalin si rrjedhojë e punës së IKD-së (dhe jo vetëm) të cilat botohen në një faqe të veçantë interneti dhe shërben si burim primar për hulumtues dhe gazetarë.
- Raporte gazetareske ditore për seancat gjyqësore
- Lajme të përditshme për sistemin e sundimit të ligjit
- Analiza të lajmeve në baza të përjavshme
- Raporte hulumtuese, gazetareske, sa i përket sundimit të ligjit
- Emisione televizive të specializuara për fushën e sundimit të ligjit.

Ekipi i IKD-së

Personeli i IKD-së ka përvojë të madhe në kapacitete të ndryshme në sektorin e drejtësisë në Kosovë, duke përfshirë zhvillimin e hulumtimeve dhe analizave ligjore, raportimet dhe hulumtimet gazetareske, ngritjen e vetëdijes, dhe përfshirjen në aktivitete të avokimit. Këtu përfshihet puna e ngushtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë për të siguruar pavarësi, paanshmëri dhe ngritje të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të raportimit në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe paraqesin një pasqyrë të plotë të ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur në Institutin i Kosovës për Drejtësi – IKD më 2024.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parave të gatshme, në bazë të cilës të ardhurat dhe shpenzimet njihen në momentin kur janë pranuar apo paguar. Organizata përdor programin e financave QuickBooks dhe fajlla të Excell-it për regjistrimet financiare dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.2 Valuta e përdorur

Valuta e përdorur për raportim nga ana e Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD është valuta e bashkësisë evropiane Euro (“EUR”).

2.3 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

Një përmbledhje e politikave më të rëndësishme të kontabilitetit të përvetsuara për pregaditjen e pasqyrave financiare janë prezentuar më posht:

2.3.1 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, parja dhe ekuivalentet e parase janë kosideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shume se tre muaj.

2.3.2 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet janë njohur si të hyra për periudhën të cilës i takojnë. Në fund të vitit mbetja e të ardhurave mbi shpenzimet trajtohet si suficit.

2.3.3 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet e ndodhura për gjenerimin e të hyrave janë njohur në periudhën përkatëse në bazë të kostos historike.

2.3.4 Tatimet

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD është e regjistruar si organizatë jo-profitabile nën rregulloret e Kosoves, dhe e posedon statusin e beneficuar si OJQ, prandaj është e përjashtuar nga tatimi mbi korporata mbi të tepicën e të hyrave ndaj shpenzimeve.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

3. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKA

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD ka nëntë (9) llogari bankare në EUR të hapura në Bankën për Biznes – BpB dhe një (1) llogari që operon në USD që shërben vetëm për pranimin e donacioneve në USD.

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Paraja në bankë	69,200	130,488
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	69,200	130,488

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
INL CLARD	43,696	-
Fondet e Organizatës	7,756	-
RTK	-	12,700
USAID	-	4,768
Totali i Llogarive të Arkëtueshme	51,452	17,468

5. LLOGARITË E PAGUESHME

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
PTK Telekom	-	33
Global Consulting & Development Associates Sh.p.k.	-	130
HIB Petrol	-	302
Norwegian PX Kosovo shpk	63	-
IPKO - Interneti	-	76
Totali i llogarive të pagueshme	63	541

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

6. TË HYRAT E SHTYERA

	31 Dhjetor, 2024 (në EUR)	31 Dhjetor, 2023 (në EUR)
Radio Televizioni i Kosoves - RTK	-	25,426
NED	12,512	5,119
INL CLARD	26,562	10,735
MATRA	24,542	51,994
UNDP	-	8,397
UNMIK	23,851	14,989
Ambasada e Gjermanisë	4,766	-
RBF	28,356	22,176
Këshilli i Europës	-	8,580
Totali i të hyrave të shtyera	120,588	147,415

7. TË HYRAT

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Fondet e Organizatës	46,076	-
Radio Televizioni i Kosovës - RTK	-	32,700
NED	50,489	40,901
INL - CLARD	159,898	45,129
Council of Europe	-	3,960
UNDP	2,200	8,800
UNMIK	208,627	108,252
EULEX	-	17,000
USAID	58,476	9,399
INL Ambasada e SHBA-s	220,799	426,026
Youth Initiative	-	2,146
OSCE	8,000	7,800
KCSF	-	-
MATRA	13,317	74,604
RBF	45,714	41,888
Ambasada e Gjermanisë	57,375	-
Të hyrat e shtyera nga viti i kaluar	147,415	112,957
Të hyrat e shtyera	(120,588)	(147,415)
Totali i të hyrave nga grantet	897,797	784,146

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

8. PAGAT DHE BENEFITET

Pagat për Menaxhmentin dhe Administratën e organizatës gjatë vitit 2024 janë realizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Pagat bruto	81,455	82,372
Kontributet Pensionale	4,073	4,119
Totali i pagave - Menaxhmenti dhe Administrata	85,528	86,491

Ndërsa pagat për stafin e angazhuar në aktivitetet e ndryshme programore gjatë vitit 2024 janë realizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Pagat bruto	395,566	382,377
Kontributet Pensionale	19,375	19,119
Totali i pagave - Stafi per Aktivitetet Programore	414,941	401,496

9. SHPENZIMET E PRODUKSIONIT

OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD përgatitë produkte televizive, përkatësisht emisione televizive javore, të cilat transmetohen në televizione. Për këtë shkak organizata ka kontraktuar kompaninë e jashtme të produksionit "Era Communnications", e cila kryen të gjitha shërbimet e produksionit për nevojat e organizatës, ku përfshihen edhe shërbimet e produkteve tjera vizuale si promo, dokumentar, dizajn, etj.

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Shpenzimet e produksionit	177,720	118,651
Totali i shpenzimeve te produksionit	177,720	118,651

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

10. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	31 Dhjetor 2024 (në EUR)	31 Dhjetor 2023 (në EUR)
Shpenzimet per Ueb	-	1,793
Tryeza dhe konferenca	64,684	13,098
Qeraja	13,849	11,148
Auditimi	720	3,326
Transporti	20,024	23,469
Shpenzimet e komunikimit	3,114	8,966
Shpenzimet komunali	4,927	4,945
Paisje për zyre	4,749	8,197
OJQ	99,127	90,057
Shpenzimet e zyres dhe tjera	7,368	11,189
Shpenzime bankare	546	1,320
Totali i shpenzimeve tjera operative	219,608	177,508

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2024

11. PASQYRA E TË ARDHURAVE SIPAS DONATORËVE

	UNMIK	UNDP	USAID	Ambasada e Gjermanisë	MATRA	NED	OSCE	Fondet e Organizatës	INL CLARD	RBF	INL	Total
Të hyrat	208,627	2,200	58,476	57,375	13,317	50,489	8,000	46,076	159,898	45,714	220,799	870,970
Të hyrat e shtyera nga viti i kaluar	14,989	8,400	-	-	51,994	5,119	-	34,006	10,732	22,176	-	147,415
Të hyrat e shtyera	(23,851)	-	-	(4,766)	(24,542)	(12,512)	-	-	(26,562)	(28,356)	-	(120,588)
Totali i të hyrave	199,765	10,600	58,476	52,609	40,768	43,096	8,000	80,082	144,068	39,534	220,799	897,797
Shpenzimet												
Pagat dhe benefitet	107,704	1,600	41,667	12,100	34,800	40,129	7,800	32,126	67,022	33,971	121,550	500,469
Shpenzimet e produksionit	47,458	9,000	5,000	6,000	4,832	180	-	36,995	25,130	5,500	37,625	177,720
Tryeza dhe konferenca	4,562	-	3,052	-	-	1,621	-	3,559	48,626	-	3,265	64,684
Konsulenc	-	-	-	-	500	-	-	-	-	-	-	500
Qeraja	7,458	-	2,795	-	-	-	-	-	-	-	3,596	13,849
Auditimi	720	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	720
Transporti	5,025	-	3,794	-	-	-	200	1,600	-	-	9,405	20,024
Shpenzimet e komunikimit (telefon, internet)	675	-	20	-	-	929	-	-	455	-	1,036	3,114
Shpenzimet komunali (rryma, uji, bërriloku)	821	-	1,534	-	601	-	-	-	-	-	1,971	4,927
Pajisje për zyre (loq top, rafta, tavolina)	2,259	-	-	-	-	-	-	-	2,490	-	-	4,749
Pagesat për OIQ partnere	21,694	-	-	34,479	-	-	-	3,000	-	-	39,953	99,127
Shpenzime për zyre dhe tjera	1,389	-	446	-	-	182	-	2,785	229	-	2,337	7,368
Shpenzime bankare	-	-	169	30	35	55	-	17	116	63	61	546
Totali i shpenzimeve	199,765	10,600	58,476	52,609	40,768	43,096	8,000	80,082	144,068	39,534	220,799	897,797
Teprica e të hyrave ndaj shpenzimeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

12. PALËT E NDËRLIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese sic është cekur në SNK 24 "Shpalosja e palëve të ndërlidhura". Në vështrimin e mundësisë e ekzistimit të palëve të ndërlidhura, vëmendja është përqëndruar në aspektin e marrëdhënies e jo në aspektin legal.

13. MENAXHIMI I RISKUT

Kredit risku

Kredit Risku është risku që njëra palë me dështimin në përmbushjen e obligimeve financiare do ndikojë në palën tjetër të ketë humbje financiare. Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD nuk i është ekspozuar kredit riskut në aspektin e granteve që i ipen organizatave me të cilat bashkëpunon.

Risku nga kamatat

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD momentalisht nuk i është ekspozuar riskut nga kamatat bankare.

Risku nga këmbimet ndërkombëtare

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD i është ekspozuar nga këmbimet ndërkombëtare pasi që transaksionet ndodhin në valutë vendore dhe të huaj.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit paraqet riskun kur pjekuria e pasurisë dhe e detyrimeve nuk përputhen. Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD monitoron likuiditetin e sajë në baza periodike, në mënyrë që të menaxhoj obligimet e sajë në momentin kur duhet të paguhet.